



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr 4180/prot  
2

Gramsh, më 06/12/2021

Vendim  
Nr.126, datë 26.11.2021

**Për miratimin e truallit në pronësi të bashkisë Gramsh për ndërtimin e një banese për familjen e znj.Margarita Taragjini banues në fshatin Taragjin,Njësia Administrative Lenie**

Këshilli i bashkisë Gramsh,pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje,transpotit,strehimit dhe emergjencave civile,drejtoria e planifikimit,zhvillimit dhe mbrojtjes së territorit “Për miratimin e truallit në pronësi të bashkisë Gramsh për ndërtimin e një banese sociale për familjen e znj.Margarita Taragjini banues në fshatin Taragjin,Njësia Administrative Lenie”,bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”,nenet 19,63, 73,të VKM nr.334,dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”,\si dhe ,të ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015,”Për vetëqeverisjen vendore”,neni 8,pika 2;

**Vendos i:**

- I. Të miratojë dhënien e truallit me sipërfaqe 80 m<sup>2</sup> pa shpërblim për ndërtimin e banesës për strehimin e familjes së znj.Margarita Taragjini.
- II. Autorizohet kryetari i bashkisë Gramsh për lidhjen e Akt-Marrëveshjes me fondacionin “Fundjavë Ndryshe” .
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetari i bashkisë dhe administrata e saj.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë  
Xhulia Gjini

Konceptoi: Xh.Gjini  
Pranoi: G.Lena  
Miratoi: G.Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_  
Afati i ruajtjes: RHK

Kryetari i Këshillit të Bashkisë  
Greta LENA

